

KESH sh.a HYRJE

~~21 SEP 2022~~

Nr.

4716

Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIË DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË
DHE EFIÇENCËN E ENERGJISË

Nr. 6618/1 Prot.

Tiranë, më 20/09/2022

Lënda: Mbi kërkesën e Televizionit Ora News për informacion.

KORPORATËS ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SH.A

Bulevardi "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", P.O. Box 259/1, Tiranë

Për dijeni:

TELEVIZIONIT ORA NEWS

Rr. Aleksander Moisiu, Nr. 76, Ish-Kinostudio Shqiperia e Re, Tirane

Televizioni Ora News, me shkresën Nr. 220 Prot., datë 01.09.2022 "*Kërkesë për informacion*", protokolluar në MIE me Nr. 6618 Prot., datë 07.09.2022, në zbatim të nenit 22 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në ligjin Nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", ka kërkuar informacion lidhur me masat e marra nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për përballimin e situatës së krijuar në sektorin e energjisë dhe hidrokarbureve e ndikuar nga konflikti Rusi – Ukrainë.

Për sa më sipër, referuar pikës 3 sipas kërkesës së saj për informacion mbi bilancin import – eksport të energjisë elektrike deri në këtë moment dhe se si parashikohet të jetë deri në fund të vitit në sasi dhe vlerë monetare, kërkojmë angazhimin dhe bashkëpunimin tuaj për vënien në dispozicion të këtij informacioni, duke marrë në konsideratë afatet e parashikuara nga ligji Nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*".

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM





www.oranews.tv

Të parët, për lajmin e fundit

Tirane 1.9.2022

Nr. prot. 220

Lënda: Kërkesë për informacion

Drejtuar: Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë

Televizioni ORA bazuar në nenin 22 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në ligjin 119 të vitit 2014 për 'Të Drejtën e Informimit' parashtron kërkesën e mëposhtme:

Konflikti Rusi –Ukraine ka ndikuar edhe në Europë duke u reflektuar në dy sektorët të rëndësishëm si energjia elektrike dhe tregu i hidrokarvureve.

Duke u nisur nga ky fakt lutemi të na informoni në lidhje me masat që ka marrë institucioni juaj në përballimin e kesaj situatë.

A do ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike për muajt në vijim?

Kush do të ketë prioritet në kushtet e mungesës së energjisë elektrike, familjaret apo bizneset?

Si është bilanci import – eksport i energjisë elektrike deri në këtë moment dhe si parashikohet të jetë deri në fund të vitit në sasi dhe vlerë monetare?



www.oranews.tv

Të parët, për lajmin e fundit

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje te përgjigjes nga ana juaj.

